



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 452

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTEVE TË MONITORUESVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR PERIUDHËN
E MONITORIMIT 7 MARS DERI 2 MAJ 2023**

Sot më datë 6.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancë publike pasi shqyrtova çështjen me:

OBJEKTI: Vlerësimi i raportit të monitoruesve të fushatës për periudhën 7 mars – 2 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e 2, neni 79, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka caktuar 120 monitorues për fushatën zgjedhore të datës 14 maj 2023.

Monitoruesit e fushatës zgjedhore mbikqyrin përmbushjen e detyrimeve nga subjektet zgjedhore në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Monitorimi përfshin periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për periudhën 23 janar deri në 2 maj 2023, janë përcjellë 997 raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga vlerësimi që i është bërë gjetjeve në këto raporte për periudhën 7 mars deri në 2 maj 2023, rezulton se 16 prej tyre pasqyrojnë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Nenin 79, pika 2, të Kodit Zgjedhor, përcakton se “...gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamuj dhe postera, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës...”.

Neni 3, pika 2 dhe 5, i udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, përcaktojnë ndalimin e afishimit të materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit si dhe ndalimin e hapjes së zyrave zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve”.

Nga monitoruesit e fushatës zgjedhore janë konstatuar shkeljet si më poshtë vijon:

1. Për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”:

Janë hapur zyra zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a. Bashkinë Durrës, në njësinë administrative Shkozet, 80 m nga qendra e votimit shkolla “Beqir Çela”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 93126324, datë 26.4.2023.
- b. Bashkinë Kavajë, afër qendrës së votimit në pallatin e Kulturës. Raporti i monitoruesit me nr. unik 96306328, datë 16.4.2023.
- c. Bashkinë Kukës, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 88631353, datë 26.4.2023.

Janë afishuar materiale propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit në:

- a. Bashkinë Durrës, billboard në afërsi të qendrës së votimit Pallati i Sportit “Ramazan Ngjala”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 67881950, datë 27.4.2023.
- b. Bashkinë Durrës, në njësinë administrative Shkozet, flamuj në fasadë banimi me vendndodhje përballë shkollës së mesme profesionale "Beqir Cela". Raporti i monitoruesit me nr. unik 34386335, datë 27.4.2023.

2. Për subjektin zgjedhor Koalicionin “Bashkë Fitojmë”

Janë hapur zyra zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a. Bashkinë Tiranë, në adresën rr. “Artan Lenja”, 150 m nga Shkolla “Gustav Mayer” dhe 170 m nga shkolla “Naim Frashëri”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 12866137, datë 13.4.2023.
- b. Bashkinë Tiranë, në adresën rr. “Milto Tutulani”, 58 m nga Universiteti i Drejtësisë. Raporti i monitoruesit me nr. unik 11158608, datë 18.04.2023.
- c. Bashkinë Tiranë, në adresën rr. “Margarita Tutulani”, 110 m nga shkolla “Dëshmorët e Lirisë”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 88933087, datë 26.4.2023.
- ç) Bashkinë Elbasan, 50 metra nga qendra e votimit Universiteti “Aleksandër Xhuvani”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 70573605, datë 24.4.2023.
- d. Bashkinë Kukës, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 4255904, datë 26.4.2023.

Janë afishuar materiale propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit në.

- a. Bashkinë Tiranë, në 2 shtylla ndriçimi, në njësinë nr. 7. Raport i monitoruesit me nr. unik 86147979, datë 4.4.2023. Nga verifikimet rezulton se në njërin shtyllë janë hequr dhe në tjetrën vazhdojnë të jenë të afishuara.
- b. Bashkinë Tiranë, në shtylla ndriçimi, në rrugën “Veli Dedi”. Raport i monitoruesit me nr. unik 84662092, datë 26.4.2023.
- c. Bashkinë Durrës, në fasadën e qendrës tregtare “Flagship”. Raport i monitoruesit me nr. unik 82766195, datë 25.4.2023. Nga verifikimet e kryera pas raportimit nga monitoruesit rezulton se materialet propagandistike janë hequr nga subjekti zgjedhor.

3. Për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”:

Janë hapur zyra zgjedhore në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në:

- a. Bashkinë Tiranë, në adresën rr. “Nasip Pavllo”, 180 m nga liceu “Jordan Misja”. Raport i monitoruesit me nr. unik 27642419, datë 28.4.2023.
- b. Bashkinë Fier, afër qendrës së votimit shkolla “Janaq Kilica”. Raporti i monitoruesit me nr. unik 53571512, datë 10.4.2023. Nga verifikimet e kryera pas raportimit nga monitoruesit rezulton se zyra zgjedhor është mbyllur nga subjekti zgjedhor.

4. Për subjektin zgjedhor Aleanca Progresiste “LZHK”

Është afishuar material propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit në:

- a. Bashkinë Tiranë, në fasadë banimi në rrugën “Fatos Baxhaku”. Raport i monitoruesit me nr. unik 65371694, datë 20.4.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, e 2, 79, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e menjëherëshme të zyrave zgjedhore, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Kukës dhe Tiranë, si vijon:
 - a) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në njësinë administrative Shkozet, 80 m nga qendra e votimit shkolla “Beqir Çela”, Bashkia Durrës;
 - b) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër qendrës së votimit në pallatin e Kulturës, Bashkia Kavajë;
 - c) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”, Bashkia Kukës;
 - ç) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Artan Lenja”, 150 m nga Shkolla “Gustav Mayer” dhe 170 m nga shkolla “Naim Frashëri”, Bashkia Tiranë;
 - d) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Milto Tutulani”, 58 m nga Universiteti i Drejtësisë, Bashkia Tiranë;
 - dh) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Margarita Tutulani”, 110 m nga shkolla “Dëshmorët e Lirisë”, Bashkia Tiranë;
 - e) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, 50 metra nga qendra e votimit Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Bashkia Elbasan;
 - ë) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”, Bashkia Kukës;
 - f) Të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, në adresën rr. “Nasip Pavllo”, 180 m nga liceu “Jordan Misja”, Bashkia Tiranë.
2. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen menjëherë të materialeve propagandistike, në Bashkitë Durrës dhe Tiranë, si vijon:
 - a) Billborder i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në afërsi të qendrës së votimit Pallati i Sportit “Ramazan Ngjala”, Bashkia Durrës;

- b) Flamuj të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në fasadë banimi, përballë shkollës së mesme profesionale "Beqir Cela" në njësinë administrative Shkozë, Bashkia Durrës;
 - c) Materiale propagandistike të koalicionit "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi", Bashkia Tiranë;
 - ç) Materiale propagandistike të subjektit zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", në fasadë banimi, në rrugën "Fatos Baxhaku", Bashkia Tiranë.
3. Ky vendim ju njoftohet subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI